

UDHËZIM
Nr. 9, datë 23.2.2018

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN E MASH-IT NR. 21, DATË 23.7.2010, “PËR
NORMAT E PUNËS MËSIMORE-EDUKATIVE DHE NUMRIN E NXËNËSVE PËR
KLASË NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 26, pika d, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,
UDHËZOJ:

Në udhëzimin e MASH-it nr. 21, datë 23.7.2010, “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën “IV”, “Norma të veçanta”, pas shkronjës “b”, të pikës 2, shtohet shkronja “c”, me përmbajtjen si më poshtë:

“c. Për zhvillimin e veprimtarive të miratuara në kuadër të programit të nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, ora e studimit të trajtohet e barasvlershme si orë mësimore, për efekte financiare. Në çdo institucion arsimor të përfshirë në nismë të realizohen jo më shumë se 3 orë studimi në ditë për çdo klasë të krijuar”.

2. Në pikën “V”, “Numri i nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me përmbajtje si më poshtë:

“3.1 Numri i nxënësve për klasë në kuadër të programit të nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, të jetë 25 nxënës për një klasë studimi. Në rastet kur numri i nxënësve për një klasë studimi nuk plotësohet me 25 nxënës, shkolla mund të krijojë një klasë studimi me jo më pak se 15 nxënës.”

3. Këto shtesa zbatohen në të gjitha shkollat e përfshira në programin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” sipas urdhrit nr. 11, datë 10.1.2018, “Për pilotimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, në institucionet shkollore të arsimit bazë”.

4. Efektet financiare për zbatimin e këtij udhëzimi përballohen me fondet e buxhetit të shtetit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 8.3.2017, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorja e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorja e Mirëmenaxhimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, njësitë arsimore vendore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla